



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272893
Datë: 08.02.2024
Numri i dokumentit: 05303037

C – IV. – 15 - 0775

Paditësja :

Kompania Rajonale e Mbeturinave, (KRM) “P” SH.A, me seli në Prishtinë.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55 , Prishtinë.

Objekti i çështjes: Kompensimi i faturave të pa paguara.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.08.02.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) “P” me seli në Prishtinë e paraqitur kundër të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe Vendimi, PRN104-0006 i dt.03.04.2015 i të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoritetit të Likuidimit (AL), **NDRYSHOHET pjesërisht**, në atë mënyrë që **OBLIGOHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, t’ia kompensoj faturat e pa paguara edhe për 2 njësi të ndryshme, nën 1, për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 euro, 2. për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 euro e në shumën e përgjithshme prej **55.029.04 € (pesë dhjetë mijë e një zetë e nëntë euro e katër centë)** nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh) “Tregu” me seli në Prishtinë (në likuidim), dhe se shuma e pranuar, duhet të përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit derisa Vendimi, PRN104-0006 i dt.03.04.2015 i të paditurës, Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për faturën e pa paguar për njësinë për Kodin # 721 për periudhën korrik 2014 në shumën prej **3,540.52 € (tre mijë e pesë qind e dy zetë euro e pesëdhjetë e dy cent)** nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “Tregu” me seli në Prishtinë (në likuidim), **VËRTETOHET pjesërisht, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 13 maj 2015, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "P" SHA, parashtrori ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN104-0006 të dt.03.04.2015, e me të cilin Vendim kërkesa e ankuesit për pagesën e borxhit në shumën e pretenduar në tërësi prej 58.569.56 €, në emër të kompensimit për fatura të papaguara nga NSH "Tregu" me seli në Prishtinë (në likuidim), është pranuar pjesërisht në shumë prej 3.540.52 €, ndërsa është refuzuar si e parashkruar në shumë prej 55.029.04 €, në pretendimin për shkak të vërtetimit të jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesa e KRM "P" Sh.A. me seli në Prishtinë (në likuidim), në shumën e pretenduar 58.569,52 €, të pranohet në tërësi si e vlefshme.

Pala paditëse parashtrësën e ka titulluar si "*kërkesë për rishqyrtim*", mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësave me të cilat bëhet "*nisja e procedurave*" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi më tej thekson se pretendimi për parashkrimin e kërkesës është i pabazuar, sepse subjekti në likuidim, faktikisht dhe juridikisht, ka pranuar ekzistimin e obligimit në atë mënyrë që gjatë periudhës korrik 2006 deri shkurt 2010, i njëjti kohë pas kohe ka paguar mbi 95 këste pjesë të obligimit, ndërsa ka mbetur borxh edhe për pjesën sipas kërkesës së parashtruar, andaj në bazë të këtij fakti dhe duke u bazuar në dispozitën nga nenin 368 par.1 dhe 2 të LMD, rezulton se i njëjti ka pranuar borxhin, prandaj nuk mund të flitet për parashkrim të borxhit.

Padisë si provë i ka bashkangjitur kopje: pasqyrat e historiatit nga evidencat financiare të kontabilitetit .

Me dt.14.11.2023, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje ndaj ankesës së paditësit të parashtruar kundër Vendimit PRN104-0006 dt.03.04.2015, të AL-së, se i përmbahet qëndrimit se autoriteti i Likuidimit, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore, duke pretenduar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria i vendimit të AL, dhe se ankesat duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me nenin 74.2 të Ligjit Nr.04/L – 034 për AKP-në, se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara dhe ta parashkruara nga neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP, se AL ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se "*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*", dhe se nuk ka asnjë provë se para se t'i drejtohet AL-së në procedurën e likuidimit, parashtruesi ka paraqitur këtë kërkesë para ndonjë gjykata apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent që nga viti 2010 e datë që korrespondon me pagesën e fundit përkundrejt parashtruesit të kërkesës, dhe se nga neni 374 i Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet (1978), parashikon se pretendimet reciproke kontraktuale në sferën e shitjes mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen pas një periudhe tre vjeçare. Në varësi të dispozitave e mësipërme kërkesat duhet të jenë paraqitur në gjykatë apo te ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare që është tre vite nga viti 2010, kur parashtruesit nuk i është kryer pagesa e faturave, dhe i paraqet gjykatës që të refuzoj kërkesën e paditësit si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe ta vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, dhe si provë ia ka bashkangjitur Vendimin e AL-së, PRN104-0006 të dt.03.04.2015.

Me Urdhrin e kësaj gjykate dt.15.11.2023, paditësit, i është dërguar mbrojtja (përgjigja) e të paditurës, për të cilën paditësi me dt. 30.11.2023, ka parashtruar përgjegje ndja mbrojtjes duke përsëritur qëndrime te paraqitur në padi dhe duke komentuar lidhur me vendosjes e Gjykatës Supreme për raste tjera, duke i konsideruar krejtësisht të kundërta me Vendimin e atakuar të AL-së.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme DhPGJSK)), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji .

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses, duhet pranuar pjesërisht si e bazuar, dhe Vendimi, PRN104-0006 i dt.03.04.2015 i të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoritetit të Likuidimit (AL), duhet të ndryshohet pjesërisht, për pjesën e refuzuar të kërkesës së paditësit në procedurën e likuidimit derisa për pjesën e pranuar të kërkesës në procedurën e likuidimit, pjesërisht duhet të vërtetohet si i drejtë dhe si i bazuar në ligj.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditëses.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se NSH “Tregu” me seli në Prishtinë (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.19.06.2013, ndërsa paditësi kërkesën, PRN104-0006, tek AL-ja, e ka paraqitur për kompensim për fatura të papaguara për tre njësi të ndryshme, nën 1, për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 €, 2. për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 € dhe 3. për Kodin # 721 për periudhën korrik 2014 në shumë prej 3,540.52 € e në shumë totale prej 58,659.56 €, dhe se e AL-ja me Vendimin, PRN104-0006 të dt.03.04.2015, kërkesën e ankuesit për pagesën e borxhit në shumën e pretenduar në emër të kompensimit për fatura të papaguara nga NSH, “Tregu” me seli në Prishtinë (në likuidim), e ka pranuar pjesërisht në shumën prej 3.540.52 € ndërsa e ka refuzuar si të parashkruar për pjesën në shumë prej 55.029.04 €, e më gjerësisht si në këtë Vendim të AL-së derisa paditësi, pas pranimi të këtij vendimi në procedurën e likuidimit, pas dt.14.04.2015, kërkesën/ankesë/padinë kundër Vendimit të AL-së, PRN104-0006 të dt.03.04.2015, pranë DHGJSK-së, e ka paraqitur me dt.13.05.2015, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas pranimi të këtij Vendimi të AL-së dhe se pjesë e shkresave të lëndës, është edhe Vendimi, PRN104-0006 I AL-së i dt.03.04.2015

Gjykata, vlerëson se padia/ankesa e paditëses, i plotëson kriteret e afatshmërisë dhe pranueshmërisë në aspektin procedural nga dispozitat e nenit 36 dhe 74 Ligjit, Nr.06-L-086 për

Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese në mesë të palëve ndërgjyqëse, pra paditësit dhe të paditurës, NSH “Tregu” - Prishtinë (në likuidim), ka ekzistuar raporti juridik i ofrimit të shërbimeve, për të cilën kjo vërtetohet me kartelat financiare e shfrytëzuesit, dhe se nuk është kontestuese se paditësi ka kërkuar që nga NSH të realizoj borxhin në shumën e pretenduar në tërësi prej 58.569.56 €, në emër të kompensimit për fatura të papaguara dhe atë për tre njësi të ndryshme me kodet si në vijim: 1). Nr. 001066 për periudhën korrik 2006- prill 2007 në shumë prej 22.238.39 euro, 2). Nr. 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 euro dhe 3). Nr. 721 për periudhën korrik 2014 në shumë prej 3540.52 euro, nga NSH “Tregu” në likuidim, e cila kërkesë është pranuar nga AL-ja pjesërisht në shumë prej 3.540.52 euro, për periudhën korrik 2014 në shumë prej 3,540.52 euro, ndërsa është refuzuar si e parashkuar për dy njësitë tjera në shumë prej 55.029.04 euro, dhe atë me Vendimin PRN104-0006 të dt.03.04.2015 të Autoritetit të Likuidimit, me atë se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara dhe ta parashkuara nga neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP, se AL-ja, ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se *“elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*, dhe nga nenin 374 i Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet (1978) parashikon se *“pretendimet reciproke kontraktuale në sferën e shitjes mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet”*, duke konsideruar paditësja se AL-ja, vendimin e ka marrë pa vërtetuar drejtë gjendjen faktike si dhe gabimisht duke zbatuar dispozitat materiale me rastin e vendosjes, pasi që e paditura kohë pas kohe gjatë periudhës korrik 2006 deri shkurt 2010, ka paguar mbi 95 këste pjesë të obligimit, duke e konsideruar se e paditura e ka pranuar borxhin, dhe se nuk mund të flitet për parashkrim të kërkesës së paditëses.

Gjykata ka konstatuar se në rastin konkret kërkesa e paditëses për kompensimin e faturave të pa paguara, bënë pjesë në kategorinë e kërkesave të pa siguruara nga neni 40 par.1 pika 1.7 e Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për prioritetet e kërkesave dhe interesave, aty parashihet se : *“Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”*.

Në nenin 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, që bënë fjalë për kërkesa periodike, aty thuhet se : *“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla ... parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”*. Derisa dispozitë të ngjashme për këtë natyrë të detyrimit në të holla e ka edhe Ligji, Nr.04/L-077 i dt.10 maj 2012 i Marrëdhënieve të Detyrimeve të Republikës së Kosovës, dhe atë në nenin 353 që flet për Kërkesat periodike e në të cilin, thuhet se : *“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë ...”*.

Po ashtu në nenin 374 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, që bënë fjalë për kërkesat reciproke nga kontrata në qarkullimin emallrave e të shërbimeve, thuhet se :“ *Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer*”.

Përkitazi me parashkrimin e kërkesave përfshirë edhe për mirëmbajtjen e pastërtisë bëhet fjalë në nenin 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, e në të cilin thuhet se :” *Parashkruhen për një vjet:kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e sPt të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake*“ kurse për ndërprerjen e afatit të parashkrimit, flitet në nenin 388 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, e ku është përcaktuar se: “*Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës*”. Derisa dispozitë të ngjashme për ndërprerjen e parashkrimit për shkak të ngritjes së padisë, ka edhe neni 369 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), nr.04/L-077, e në të cilin, thuhet se :”*Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës*”. Pra, në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesat në mes 2 (dy) personave juridik dhe nuk është shërbim për nevojat shtëpiake – amvisërie e për të cilat vlen afat 3 (tre) vjeçar i parashkrimit të tyre dhe se me paraqitjen me kohë të kërkesës kreditore me dt.27 gusht 2014 Gusht 2006 nga paditësi në procedurën e likuidimit, pranë AL-së, si autoritet kompetent për shqyrtimin e saj, e me pranimin e pjesshëm të kërkesës së paditësit në procedurën e likuidimit si dhe me bërjen e pagesës në faturat njësi të ndryshme, nën 1, për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 euro, 2. për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 euro e sipas datave gjegjëse dhe viteve gjegjëse, është ndërprerë afati i parashkrimit edhe për pjesën e refuzuar të detyrimit në të holla sepse paditësi, ka prova se pala e paditur, ka bërë pagesa mujore në secilën faturë dhe se me pranimin e pjesshëm të kërkesës për njësinë e Kodin # 721 për periudhën korrik 2014 në shumë prej 3,540.52 €, e ka pranuar në mënyrë të tërthortë borxhin pra edhe faturat e pa paguara për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 €, dhe për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 € e në shumën e refuzuar prej 55,029.04 €.

Në këtë çështje juridike gjykata gjen se nuk qëndron pretendimi i paditëses, se e paditura e ka pohuar borxhin spese e njëjta në procedurën e likuidimit, ia ka pranuar një pjesë të detyrimit në të holla për faturat e pa paguara dhe atë për Kodin # 721 për periudhën korrik 2014 në shumë prej 3,540.52 € dhe se kjo nënkuton pranimin e borxhit edhe për faturat tjera të papaguara për tre njësi të ndryshme, nën 1, për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 €, dhe për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 € e në shumën e refuzuar prej 55,029.04 € dhe se e paditura me rastin e vendosjes në procedurën e likuidimit, ka vepruar pjesërisht drejtë kur e ka pranuar pjesërisht kërkesën e paditëses për një pjesë të saj dhe pjesërisht nuk ka vepruar drejtë e ka refuzuar si të pa vlefshme pjesën tjetër të kërkesës së paditëse, pra se kërkesa e paditësit, është e pas aftëshme sipas dispozitave të zbatueshme ligjore nga neni 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP lidhur me nenin 374 të LMD (1976), duke e konsideruar si të parashkruar, pra nuk është i drejtë ky qëndrim i shprehur i AL-së në Vendimin e tij, PRN104-0006 i dt.03.04.2015, pasi që kërkesat periodike kanë rrjedh të veç e veç të afateve, si dhe çdo kërkesë e veçantë mujore eventuale, është

argumentuar me prova konkrete materiale (pagesa e kësteve në faturat respektive nga e paditura me mbi 95 këste për vitet gjegjëse, dhe pranimit i pjesëshëm i kërkesës nga e paditura në procedurën e likuidimit) e për të cilën pala paditëse, ka arritur të dëshmoj një fakt të tillë se nuk ka parashkrim edhe të pjesës së refuzuar të kërkesës së paditëses në procedurën e likuidimit. Andaj edhe kjo gjykatë e pranoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit edhe për pjesën e refuzuar të kërkesës së saj nga faturat e pa paguara për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 euro, dhe për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 euro e në shumën e refuzuar prej 55,029.04 € ndërsa Vendimin e AL-së, PRN104-0006 i dt.03.04.2015, pjesërisht e vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj për njësinë Nr. 0721 për periudhën korrik 2014 në shumën prej 3,540.52 euro sepse sipas kartelës financiare, nga NSH, “Tregu” me seli në Prishtinë (në likuidim) sepse qëndrimin e të paditurës, nuk argumentojnë dispozitat e nenit 36.2.1 dhe 2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP lidhur me nenin 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), pasi që pretendimet e parashtrueses, këtu paditëses, edhe pse i referohen periudhës kohore Korrik 2006 - shkurt 2010, sipas kartelave financiare të shfrytëzuesit, dhe pas pranimit të pjesëshëm të kërkesës si dhe me pagesat e 95 kësteve nga faturat respektive për vitet gjegjëse, kërkesa e paditëses për pjesën e refuzuar të kërkesës, nuk konstatohet të jetë e pas afatshme dhe e parashkruar siç pretendon edhe pala e paditur.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës

Gjykata vlerëson se, nuk është i bazuar dhe i drejtë qëndrimi i të paditurës i shprehur në Vendimin e AL-së, PRN104-0006 i dt.03.04.2015 kur kërkesën e paditëses në emër të kompensimit për fatura të pa paguara, për periudhën e që pretendohet të mos jenë paguar duke e konsideruar si të pas afatshme dhe të parashkruar sipas nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, lidhur me nenin 374 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) dhe se qëndrimi i AL-së në kërkesën e parashtruar duke vlerësuar si të pavlefshme të kërkesën sepse me pranimin e pjesëshëm të kërkesës së paditësit në procedurën e likuidimit si dhe me bërjen e pagesës në faturat njësi të ndryshme, për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 €, për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 € e sipas datave gjegjëse, është ndërprerë afati i parashkrimit për pjesën e refuzuar të detyrimit në të holla sepse paditësi, ka prova se pala e paditur, ka bërë pagesa mujore në secilën faturë dhe se me pranimin e pjesëshëm të kërkesës për njësinë e Kodin # 721 për periudhën korrik 2014 në shumë prej 3,540.52 €, e ka pranuar në mënyrë të tërthortë borxhin edhe për faturat e pa paguara për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007, në shumën prej 22.238.39 €, dhe për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 € e në shumën e refuzuar prej 55,029.04 €. Andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë pas konstatimit të gjendjes faktike, gjeti se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditëses, Kompania Rajonale e Mbeturinave, (KRM) “P” SH.A, me seli në Prishtinë për kompensimin e faturave të pa paguara për 2 njësi të ndryshme, për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 euro, dhe për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 euro e në shumën e refuzuar të kërkesës prej 55.029.04 euro, është e bazuar dhe Vendimi, PRN104-0006 i dt.03.04.2015, duhet të ndryshohet pjesërisht, dhe duhet të detyrohet, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, t’ia kompensoj faturat e pa paguara edhe për 2 njësi të ndryshme, për Kodin # 001066 për periudhën korrik 2006 - prill 2007 në shumë prej 22.238.39 euro, për Kodin # 00719 për periudhën tetor 2007- shkurt 2010 në shumë prej 32.790.65 euro e në shumën e përgjithshme prej 55.029.04 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH) “Tregu” me seli në Prishtinë (në likuidim), dhe se Vendimi, PRN104-0006 i dt.03.04.2015 i Autoriteti i Likuidimit (AL) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), “Tregu” me seli në Prishtinë

(në likuidim), për Kodin # 721 për periudhën korrik 2014 në shumë prej 3,540.52 €, duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsytetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe Udhëzimit Administrativ, Nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të përkatësisht nenit 13.3 dhe 13.9, të këtij Udhëzimi, gjykata vendosi që secila palë t'ia bartë shpenzimet e veta procedurale pasi që pala paditëse, edhe pse ka pasur sukses në procesin gjyqësor, e njëjta nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:272893, 08.02.2024

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).